VENDIM
Nr. 102, datë 29.3.2017

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 29.3.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar Biba	kryetar
Hysen Osmanaj	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes së mandatit të deputetit të z. Ervin Koçi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 990/1 prot., datë 24.3.2017, drejtuar KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Ervin Koçi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Fier.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 29, datë 2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Fier për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 9 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë për qarkun Fier, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një) z. Gramoz Kaso Ruçi, 2 (dy) z. Erion Mirdash Braçe, 3 (tre) znj. Eglantina Muharrem Gjermeni, 4 (katër) z. Ilirjan Hyda Celibashi, 5 (pesë) z. Armando Subashi, 6 (gjashtë) z. Arben Kristaq Çuko, 7 (shtatë) z. Piro Dano Lutaj, 8 (tetë) znj. Majlinda Daut Bufi, 9 (nëntë) z. Ervin Agim Koçi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave të njëpasnjëshme, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Ilirjan Hyda Celibashi, znj. Eglantina Muharrem Gjermeni, znj. Majlinda Daut Bufi, z. Armando Nikolla Subashi, deputetë të zonës zgjedhore qarku Fier, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin 228, datë 7.5.2015 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Avdulla Çela.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë në qarkun Fier i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste të Shqipërisë në zonën zgjedhore qarku Fier.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, pjesëtare e koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013", ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë për 12 zonat zgjedhore.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë për qarkun Fier, kandidati i radhës është kandidati me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) z. Xhevit Qemal Bushaj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga ndërprerja e mandatit të z. Ervin Agim Koçi është z. Xhevit Qemal Bushaj, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 12 (dymbëdhjetë).

Z. Xhevit Qemal Bushaj, me shkresën nr. 289 prot., datë 27.3.2017, depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, deklaron se ka qenë në detyrën e Prefektit të qarkut Fier, nga e cila ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme.

Referuar nenit 63, pika 3 dhe pika 4, germa "e", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre për zgjedhjet në Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore.

Me dorëheqjen nga detyra e prefektit përpara zgjedhjes z. Xhevit Bushaj plotëson kushtet e parashikuara nga neni 63 i Kodit Zgjedhor për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Xhevit Qemal Bushaj, referuar nenit 3, nenit 5, pika 4, germa "dh", duke qenë në funksionin e Prefektit të qarkut Fier, ka depozituar formularin e vetëdeklarimit në Kryeministri si organi përgjegjës për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, që ka pasur në momentin e depozitimit të formularit.

KQZ-ja, me shkresën nr. 1859 prot., datë 27.3.2017, i kërkoi Kryeministrisë kopje të formularit të vetëdeklarimit dhe informacionin në lidhje me rezultatet e verifikimit për kandidatin për deputet në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier z. Xhevit Qemal Bushaj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Xhevit Qemal Bushaj, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Sipas informacionit të ardhur nga Kryeministria, në KQZ, rezulton se z. Xhevit Qemal Bushaj kandidat për deputet në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier, është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Për sa më sipër, mandat i ndërprerë i përket kandidadit të radhës, pas z. Ervin Agim Koçi, i renditur me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zonën zgjedhore qarku Fier, z. Xhevit Qemal Bushaj.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a" dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë qarku Fier, z. Xhevit Qemal Bushaj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Denar Biba